

Savoir sans Frontieres
<http://www.savoir-sans-frontieres.com>


Jean-Pierre Petit

HiRUSHJA 2000




Traduit par : ALBAN LAIGLE

Në një mbretëri deri tani pa histori.
Mbreti Gjergj duket i rënë në hall




Filip, ç'po bën ende aty,
pashë Zotin ?

Një makinë, baba,
një makinë pér të...
fluturuar



Lakuriqët
e natës nuk
kanë pupla dhe
megjithatë
fluturojnë po
aq mirë sa zogjtë,
me sa di unë.



Të ndërtosh flatra të ngjashme
me të tyret është diçka e lehtë.
Por më mungon diçka : forca pér
t'i lëvizur. Çfarë mekanike mund
ta bënte të mundshme një
mrekulli të tillë ?


E kupton ti që ende nuk je martuar dhe se mbretëria
nuk ka trashëgimtar? Po mplakem unë, ti e di.



Po, baba, por që një burrë
dhe një grua të jenë bashkë,
duhet që ata të kenë shije të
përbashkëta! Mirëpo asnëjëra
prej grave që ti më ke paraqitur
nuk merakoset fort për
të fluturuar.

e si do ta njohësh ti gruan e ëndrrave të tua?
do të jetë grua zog apo grua lakuriq nate?

një magjistar më ka thënë
se do ta njoh që me vështrimin
e parë.



im birështë çmendur



kalëron mbi utopira.
Dhe ndërkohe vitet kalojnë...
kalojnë...

Zotëri, mos u trishton!

Ky zog i rrallë duhet të ekzistojë dikund,
në tërë këtë mbretëri. Nuk keni tjetër
veçse të organizoni një ballo të madhe
në kështjellë, ku të jenë ftuar të gjitha
vajzat e reja, të mira për t'u martuar.



një ballo, hmm... po, por ku do të ftoheshin vetëm vajza të reja të rangut të lartë

Kuptohet kjo.
Por Filipi nuk ua vë shumë mendjen titujve të princeshave. Për t'i thjeshtuar gjërat, ju këshilloj që madhëria juaj të organizojë një **BALLO ME MASKA**.

Ashtu qoftë. Cakto datën dhe le të dalin lajmëtarët e mi ta shpallin këtë vendim në tërë mbretërinë.

Mirë, zotëri, do të merrem me këtë që tanë.

Në mbretëri jetonte një burrë i urtë që kishte një vajzë. Duke qenë i ve, ai u martua për së dyti me një grua që kishte pasur dy vajza nga një martesë e mëparshme. Pastaj ky burrë i urtë vdiq. Kjo grua e cila kishte kërkuar thjesht t'ia merrte pasurinë doli se na ishte një njerkë e përbindshme, që e trajtoi jashtëzakonisht keq jetimen e vogël, duke e nënshtuar thjesht në ca punë të pista kuzhine.

E veshur tèrë rrecka, e trajtuar
me ashpërsi nga njerka, ajo kryente
përditë punët më të pista, duke
mos pushuar tèrë ditën e ditës.
Në të rënë të natës, ajo e kishte
zakon të ulej pranë zjarrit,
në hirin e vatrës.



Mbreti na ka dërguar në tërë mbretërinë.
Më dhjetë të muajit të ardhshëm, të gjitha vajzat e reja duhet
të vijnë në një pritje, pa përjashtim, për një ballo me maska.
Të gjitha vajzat e reja për t'u martuar.

ja tre ftesat,
për tre zonjushat e familjes suaj.

tre ? mami, po ne
jemi vetëm dy këtu !

e treta
jam unë...

Sigurisht, Hirushja ka plotësisht
të drejtë të shkojë në këtë ballo.
Madje maskimi i saj është tashmë gati.
I ngelet thjesht për të ardhur.



Ditët kaluan dhe data e ballos erdhi.
Shërbëtorët e kështjellës së mbretit,




i cili kishte vendosur se balloja do të mbahej
në kopshtin përpara, të rrethuar me mure të lartë,
po merreshin me zbulimin e tij me shandanë dhe
me një pistë të gjerë vallëzimi.



Ato ishin veshur që të dyja si princesha,
me shpresën që t'i binin në sy Filipit









madje e di ku është. E ka futur në një sirtar të komodinës, në dhomën e vet. Nuk do të jetë e lehtë për ta marrë.

Sidoqoftë, zonja nuk e kishte parashikuar kurrë se kjo Hirushe do të shkojë në këtë ballo. Duhet vjedhur kjo kartë.


Por si t'ia bëjmë të hyjmë në dhomën e saj pa na kapur brenda? Madje ajo është aty tanë dhe rri zgjuar deri natën vonë.

Këtë kartë, duhet të shkosh ta marrësh ti, por jo e veshur kështu. Duhet të gjej diçka tjetër.

Mjauu!




Pa asnjë zhurmë, e veshur kështu,
Hirushja përvidhet në shkallën e errët të kullës



Hirushja në ballo,
tek mbreti, mos more ! e çfarë
mbeti tjetër pastaj !!

Ah Ah...



mori fund gjithçka. E ka djegur ftesën

Ah, shpirtliga


por mos u shqetëso.
Kam ende gjëra të tjera në çantë







falë tyre, pelerina
do të të ngrejë në ajër
dhe kështu do të mund
të futesh në festë duke
kapërcyer murin rrëthues.
Dhe do të të sjellin sërisht
këtu. Por më dëgjo
mirë tani




Të duhet me pat jetër që të largohesh
para mesit të natës, përndryshe magjia
jote nuk pi më ujë, dhe pelerina nuk
mund të të mbartë më në ajër



falemnderit, ndrikull




dhe mos harro !
këmbana e dymbëdh
jetë e mesnatës !



i shoh dritat
e kështjellës

atëherë, Madhëria juaj, kjo
ballo është një sukses, apo jo ?




biri juaj, Filipi, zakonisht
aq i hutuar, aq i humbur,
nuk pushon së vallëzuari me
trashëgimtaret më të pasura
të mbretërises.



në fakt, ashtu është, duket se po
argëtohet mirë. Por mos u dashka atëherë
që të organizoj një ballo me maska në oborrin
tim, për çdo javë, e që kështu ta detyroj të
interesohet për tjetër gjë sesa për gjuetinë
dhe makinat e tij fluturuese ?

për besë, duket se i pëlqen







Hirushja, që nuk e di se është duke vallëzuar
në krahët e Princ Filipit, nuk i sheh orët që kalojnë

befas !...

Oh, Perëndi,
ora !...

DONG

si, çfarë, ora ?

më falni. Më duhet të
largohem, menjëherë !

menjëherë !!!?
Po festa sa po
ka filluar

Më duhet të
kthehem në shtëpi
sa më shpejt

DONG!



po kjo është...
absurde ! Nëse keni
nevojë për një karrocë,
njerëzit e mi mund
t'ju shoqërojnë

më dëgjoni ! kjo
shkalla nuk ju çon askund,
në mos në një tarracë.
Dalja e kështjellës është
në drejtimin e kundërt !?!

do të doja t'ju shoh
sërisht, më thoni ku
mund t'ju gjej. Kthehuni !
Kjo tarracë nuk
ju çon askund !

DONG






Të nesërmen,
i gjithë pallati është në ethe.




Kemi fare pak tregues për ta gjetur këtë zonjushë, që është zhdukur si me magji. Duke pasur parasysh maskimin që kishte zgjedhur, ne nuk dimë madje as nëse ishte bjonde apo brune. Ia njohim thjesht shtatin, pak a shumë. Por kjo është fare pak

Madhëri, biri juaj ka rënë
në dashuri. Kjo ishte ajo
çfarë dëshironit, apo jo ?



në dashuri, po,
sigurisht, është në dashuri.
Por... me kë vallë ?!

mund të vendosim ca shpallje
duke përshkruar veshjen
e saj. Por atëherë do të
përgjigjeshin të gjitha
tyryfyçkat e mbretërisë




jo, kjo do të ishte
e fundit për t'u bërë

Filipi pretendon se ajo
di të fluturojë në ajër


krejtësisht absurde,
antishkencore !




mbase, por ky është
treguesi i vetëm që zotërojmë













Hë, ec tanj.
Është thjesht një
përrua i vogël, ec...

po t'ia tregoj
këtë eprorit tim,
do të më vrasë !



Mbi këtë pergamenë, mesazhi paska
mbetur pak a shumë i lexueshëm.
Për fat të mirë që kam marrë veglat
e shkrimit me vete. Do t'i korigjoj
të tjerat. Duhet durim...








këto quhen syze. Të ndihmojnë për të parë.
Më beso, nganjëherë të ndihmojnë dhe për të
hulumtuar të ardhmen



koha është si një kristal
përmes të cilit mund të
shohim nga të dyja anët



por të sjellësh sot gjëra
të së ardhmes, kjo mund të
shkaktojë trazira të mëdha

Magjistar, kam takuar një grua
që, siç duket, di të fluturojë.
A është e mundur kjo ?



prit, do të të tregoj diçka.
Por ku djallin e paskam vënë ?

ti e njeh kapelen e
krerëve tanë të kishës ?



ti e di që ata kanë
sjellë mjaft gjëra të së
kaluarës. Për shembull,
skeptri që mbajnë në
dorë, nuk është tjetër
veçse ai më të cilin
fallxhorët romakë
mund të parashikonin të
ardhmen, megjithëse
nuk besoj se
priftërinjtë tanë
ta kenë ruajtur
këtë dhundi.

çdo gjë ka një kuptim.
Gjithmonë kam pyetur
veten nga ku mund të
vinte kapelja e tyre dhe
më në fund e kam gjetur
përgjigjen në një vepër të
një të ardhme të largët

është një makinë fluturuese


Joo !?!

po, dhe do
të ta them si

merr një fije letër, katrore, dhe mbështille
mbi njëren prej diagonaleve, të shtrënguar mirë,
duke ia filluar nga njëri prej cepave të katorrit


derisa ky cep i mbështjellë
të përputhet pikërisht mbi
diagonale

veprimi i dytë qëndron në mbështjelljen e objektit mbi vetvete duke i mbajtur të dy cepat mbi njëri-tjetrin, me ndihmën e kësaj mrekullisë tjetër që e kam sjellë nga një prej shëtitjeve të mia në të ardhmen. Ata e quajnë këtë ngjitëse.



hedhja e objektit është mjaft delikate.

Duhet mbajtur me dy gishta nga maja që ka mbetur e lirë, dhe « shtruar në ajër » duke i dhënë një shtytje të lehtë në kahun horizontal




e punuar me kujdes dhe e lëshuar nga një shkëmb i lartë, ky mjet mund të përshkojë milje të tëra



por le të kthehem tek ajo gruaja që të fola. Gjatë fluturimit, i ka humbur kjo. Mos vallë janë germa magjike? Qeni im e ka ngrënë përgjysmë dhe mbasë nuk mund të nxjerrim ndonjë të madhe, apo jo?




Jo, nuk janë germa. Njerëzit e së ardhmes, këtë e quajnë KOD. Është një shkrim i çuditshëm që bën që, edhe po të mungojë ndonjë pjesë, mesazhi nuk zhduket, me kusht që të gjitha vizat të mbeten të dukshme.



a mund të zbërthehet
kjo formulë magjike?




po, por nuk mund ta bëj në
praninë tënde. Më lë pak të
futem në laboratorin tim



Ja. Mesazhi thoshte : lëkurë e zezë kaprolli,
masa 34, njëqind e nëntëdhjetë e nëntë franga.
Duhet të jesh i çmendur që të paguash më tepër

SNAP!

E kapa. Kjo është masa e
këpucëve të saj. Falemnderit
Magjistar. Po iki menjëherë.



Gaztor, kërko të gjitha
vajzat e reja që ishin atë natë
në ballo dhe që kanë numër
këmbe tridhjetë e katër.

dhe thuaji të vijnë me këpucët
që kishin atë natë, në ballo !

Më vonë







Prisni !



